



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M

K.P.P.669/2017

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Leonard Gremshi	Zv/Kryetar
Hektor Balluku	Anëtar
Odise Moçka	Anëtar

Në mbledhjen e datës 25.09.2017 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimin e vendimit të KVO-së mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Sireta 2F” sh.p.k nga procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur”, me Nr.REF-74760-03-29-2017 me objekt “Sistemin rrugësh blloku tek Stadiumi” me fond limit 78,906,342 lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 21.04.2017 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Pogradec.

Ankimues:

“Sireta 2F” shpk
Njësia Administrative Paskuqan Tiranë

Autoriteti Kontraktor:

Bashkia Pogradec
Bulevardi “Reshit Çollaku”

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010, “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar;

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Vlerësimi paraprak

1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

I. Në datën 29.03.2017 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur”, me Nr.REF-74760-03-29-2017 me objekt “Sistemin rrugësh blloku tek Stadiumi” me fond limit 78,906,342 lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 21.04.2017 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Pogradec.

II.1. Në datën 21.04.2017 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit, objekt ankimi.

II.2. Në datën 05.05.2017, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezulton si më poshtë vijon:

- Jogi	pa ofertë	I skualifikuar
- Vaya International	pa ofertë	I skualifikuar
- Boshnjaku B	57,511,677	I skualifikuar
- Sireta 2F	66,666,666	I skualifikuar

- Leon Konstruksion	66,693,652.81	I skualifikuar
- Shendelli&Shkëlqimi 07	67,078,530	I skualifikuar
- Alko Impex General Construction	67,642,538	I skualifikuar
- Ndrekaaj	70,997,490	I skualifikuar
- Rej	73,382,898	I skualifikuar
- Building Construction	78,117,262	I kualifikuar

II.3. Në datën 05.05.2017 operatori ekonomik “Sireta 2F” shpk është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi për arsyet si më poshtë vijon:

- Sipas DST 2 -"Kriteret e Vecanta te kualifikimit", pika 2.3 "Kapaciteti Teknik" , prg. 2.3.6 duhet nje betoni/fraksionimi guri ne nje distance jo me shume se 50 km nga objekti- NDERKOHE ska paraqitur asnje dokumentacion .
- Operatori Ekonomik “Sireta2F” shpk nuk eshte paraqitur dokumentacioni per mjete sipas kerkesave te DST qe mjete e marra me qera duhet te jene me destinacion Objektin e prokurimit
- Sipas DST 2 -"Kriteret e Vecanta te kualifikimit", pika 2.1 "Kapaciteti ligjor", vertetim nga B. Pogradec per mospasje detyrimesh- nderkohe nuk kane vertetim nga Bashkia Pogradec per taksat vendore, dhe detyrime te tjera nga verifikimi ne portalin e prokurimeve kjo shoqeri ka kryer aktivitet ne shume njesi dhe autoritete kontraktore ne te cilat nuk ka hapur nipte sekondare per ushtrim aktiviteti dhe pagimin e taksave vendore.
- Ka edhe mangesi te tjera por meqenese keto jane thelbesore nuk po vazhdojme me te tjerat

II.4. Në datën 12.05.2017 operatori ekonomik “Sireta 2F” sha ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor në mënyrë të përmbledhur me argumentet si më poshtë:

- Lidhur me arsyen e parë të skualifikimit se Sipas DST 2 -"Kriteret e Vecanta te kualifikimit", pika 2.3 "Kapaciteti Teknik" , prg. 2.3.6 duhet nje betoni/fraksionimi guri ne nje distance jo me shume se 50 km nga objekti- NDERKOHE ska paraqitur asnje dokumentacion, ngrejmë pretendimin se nuk është e bazuar. Në dokumentat e tenderit në kriteret e vecanta të kualifikimit , kapaciteti teknik pika 2.3.6. është parashikuar se 2.3.6 Kandidati ofertues duhet të kete ne pronesi, qera, perdorim ose me kontrate furnizimi nje betoni apo nje fraksionim guri te miratuar nga Pushteti vendor dhe te pajisur me dokumentacion mjedisor ne nje largesi jo me shume se 50 km nga objekti (Referuar manualit te prodhimit dhe transportit te betonit ku specifikohet se betoni nuk mund te transportohet ne nje distance me larg se 50 km). Për plotësimin e kësaj kërkesë shoqëria jonë ka dorëzuar kontratën e lidhur më datë 10.01.2017 mes shoqërisë Favina dhe shoqërisë Sireta 2F shpk. Në nenin 1 të saj parashikohet “Objekti

i kësaj kontrate është furnizimi nga ana e furnizuesit ndaj blerësit sipas nevojave të kësaj të fundit me materiale inerte, beton të markave të ndryshme. Kontrata e mësipërme është e shoqëruar me Leje Mjedisore Kategoria III.1.B për aktivitetin e përzjres së cimentos ose përdorimi i cimentos në masë të madhe.... si dhe me Akt Miratimi Leje mjedisi tipi B shoqëruar me dokumentacion provues mbi disponueshmërinë e linjës së betonit dhe të karrierës së gurit gëlqeror. Gjithashtu shoqëria jonë ka provuar se furnizuesi disponon certifikimin ISO sipas standarteve ndërkombëtare.

- Lidhur me arsyen e dytë të skualifikimit se “Operatori Ekonomik “Sireta2F” shpk nuk eshte paraqitur dokumentacioni per mjete sipas kerkesave te DST qe mjete e marra me qera duhet te jene me destinacion Objektivin e prokurimit: Ngrejmë pretendimin se nuk është e bazuar. Në DT është përcaktuar kriteri 2.3.8 .Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës:

Mjetet	Sasia	Gjendja
Kamiona	4 copë	Pronësi ose me qera
Eskavator	2 copë	Pronësi ose me qera
Fadrome	1 copë	Pronësi ose me qera
Betoniere	1 copë	Pronësi ose me qera
Autovinç	1 copë	Pronësi ose me qera

2.3.8.1 Operatori Ekonomik të paraqesë deklaratën sipas shtojcës Nr.8

2.3.8.2 Ofertuesi duhet të paraqesë për makineritë të cilat shenohen ne rregjistrin kombetar te automjeteve, lejet e qarkullimit të tyre (të cilat duhet të jenë në emër të shoqërisë), Licence dhe certifikat transport mallrash nga Pushteti vendor, Siguracionin, Kontrollin Teknik te automjetit, Taksat e qarkullimit. Për mjetet dhe pajisjet e tjera Ofertuesi duhet të paraqesë kontrate noteriale të blerjes, fatura tatimore të blerjes ose dokument zhdoganimi të mjetit.

2.3.8.3. Pranohet marrja me qira ose huapërdorje e mjeteve te mesiperme, me kusht qe kontrata/t e qiramarrjes ose te huapërdorjes te jene te lidhura para noterit per objektin qe prokurohet, me afat vlefshmerie deri ne pefundim te objektit si dhe te shoqerohen nga te gjitha dokumentat e mesiperme te pronesis se huadhenesit.

Së pari nënvizojmë se referuar formularit të shtojcës 9 mbi disponueshmërinë e mjeteve shoqëria jonë plotëson tërësisht kapacitetin teknik me mjete edhe pa qenë nevoja e deklarimit dhe dorëzimit të mjeteve të marra me qera. Kemi të bëjmë me një pretendim të padrejtë dhe të pabazuar në ligj. Konkretisht ne kemi deklaruar si mjet të marrë me qera mjetin tip eskavator

të marrë me qera në përputhje me kontratën e qirasë datë 11.06.2015 në të cilën është specifikuar afati 5 vjeçar brenda periudhës së realizimit të kontratës, si dhe cmimi dhe kushtet e pagesës së saj të shoqëruar me dokumentacion të vlefshëm.

- Lidhur me arsyen e tretë të skualifikimit ku autoriteti kontraktor ka argumentuar se “ Sipas DST 2 -"Kriteret e Vecanta te kualifikimit", pika 2.1 "Kapaciteti ligjor", vertetim nga B. Pogradec per mospasje detyrimesh- nderkohe nuk kane vertetim nga Bashkia Pogradec per taksat vendore, dhe detyrime te tjera nga verifikimi ne portalin e prokurimeve kjo shoqeri ka kryer aktivitet ne shume njesi dhe autoritete kontraktore ne te cilat nuk ka hapur nipte sekondare per ushtrim aktiviteti dhe pagimin e taksave vendore: Ngrejmë pretendimin se nuk është e bazuar pasi: Në DT Kriteret e vecanta të kualifikimit, është parashikuar: Vërtetim nga Bashkia Pogradec, se ofertuesi nuk ka detyrime ndaj Autoritetit Tonë. Do të konsiderohen detyrime të gjitha shumat që janë rrjedhojë e një detyrimi të lindur në saj të zbatimit të ligjit për taksat vendore, gjordat e ndryshme nga institucionet audituese legjitime, e çdo lloj detyrimi tjetër të parashikuar nga legjislacioni në fuqi. Vërtetimi duhet të jetë lëshuar jo më parë se 30 ditë nga data e tenderit. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzoj vërtetimin. Në lidhje me këtë arsye skualifikimi ju sqarojmë se kërkesa për tu pajisur me vërtetim nga Bashkia Pogradec është dërguar më datë 14.04.2017 pra rreth 7 ditë para zhvillimit të tenderit dhe përgjigjja e shkresës më ka ardhur më datë 24.04.2017 (pasi tenderi ishte mbyllur) . Në vërtetimin e mësipërm qartësisht konsttaohet se subjekti ynë nuk disponon asnjë detyrim ndaj autoritetit tuaj. Gjithashtu referuar ekstraktit të QKB të subjektit shoqëria jonë nuk ka ushtruar aktivitet tregëtar pranë Bashkisë Pogradec dhe si e tillë referuar ligjit për taksat vendore detyrimi lind në rast se është ushtruar aktivitet tregëtar. Në lidhje me pjesën tjetër të arsyes së skualifikimit ku ju konsttaoni se subjekti ynë ka ushtruar aktivitet në njësi të tjera por nuk ka pasqyruar ato në QKR sqarojmë se: Autoriteti juaj kontraktor në vlerësimin nëse operatori ekonomik ka shlyer detyrimet që rrjedhin nga taksat vendore duhet ti referohet vetëm vendeve kryesore dhe sekondare të ushtrimit të aktivitetit tregëtar referuar ekstraktit të regjistrimit tregëtar. Është jashtë kompetencave të autoritetit juaj kontraktor në cilësinë e një organi publik bashki të verifikojë zbatueshmërinë e ligjit nga organet e qeverisjes vendore në rast se këto të fundit kanë nisur procedurën e dërgimit të kërkesës për regjistrim dhe detyrimin e pagimit të taksave vendore. Ndaj nënvizojmë se referuar arsyes së mësipërme të skualifikimit kjo arsye është në tejkalim të kompetencave dhe i është referuar një kriteri i cili nuk është parashikuar në dokumentat e tenderit duke rënë ndesh me nenin 55 pika 2 t5ë ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 Për prokurimin publik të ndryshuar.
- Në lidhje me arsyen e skualifikimit “Ka edhe mangesi te tjera por meqenese keto jane thelbesore nuk po vazhdojme me te tjerat” mendojmë se ky pretendim jo vetëm është abuziv por mbi të gjitha është i pambështetur në ansjë fakt apo ligj. Arsyeya e mësipërme jo vetëm është abuzive por njëkohësisht është tërësisht konfuze. Sa më sipër kërkojmë kualifikimin e shoqërisë sonë.

II.5. Në datën 22.05.2017 me anë të shkresës nr.1721/1 prot ankimuesi është vënë në dijeni lidhur me pranimin pjesërisht të ankesës sa i takon arsyes së parë (për *nyje betoni/fraksionimi guri*) dhe të dytë të skualifikimit (për mjetet) dhe ka vendosur mospranimin e ankesës lidhur me arsyen e tretë të skualifikimit (për taksat vendore). Lidhur me arsyen e tretë të skualifikimit argumentimi i KSHA është si vijon: Komisioni i autorizuar vendos se referuar shkronjës d të nenint 43 të ligjit Nr.9723 datë 03.05.2007 i ndryshuar cdo subjekt mbart detyrimin ligjor të regjistrohet në vendet e tjera të ushtrimit të veprimtarisë të ndryshme nga selia dhe detyrimisht duhet të paguajë taksat dhe tarifat vendore në atë teritor ku ushtron veprimtari dhe se operatori ankimues duhet të paraqiste dokumentacion ku të vërtetonte se nuk ka detyrime në Bashkinë Tiranë, Bashkinë Bulqizë dhe Bashkinë Korçë pasi për punë të ngjashme ka dorëzuar në sistem: 1. Kontratë me Këshillin e Qarkut Korçë me objekt për kryerje punimesh “Rikonstruksion i rrugës Kryqëzimi Poloskë-Përparimaj-Cipan Loti II. 2. Kontratë me Bashkinë Tiranë për objektin “Rikonstruksion cerdheje në Shkozë viti 2015”. 3. Kontratë me Bashkinë Bulqizë për objektin “Sistemim asfaltim rruga Allmete –Durice-alle Lagjia nr.2 Vajkal viti 2015.

Gjithashtu KSHA ka nxjerë arsye të reja skualifikimi të pakomunikuara më parë ankimuesit tilla si:

- Operatori ekonomik Sireta 2F shpk nuk ka dorëzuar në sistem sigurimin e ofertës sipas shtojcës 3 të DST në masën 2% në kundërshtim me seksionin 2 pika 2.7 e DST ku shprehet se “Sigurimi i ofertës mund të dorëzohet në një nga format e mëposhtme: a) Garanci Bankare; b) Garanci Sigurimi.
- Në DST pika 2.3.10 është kërkuar: Operatori Ekonomik duhet të plotesoje kërkesat e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr 42, date 16.01.2008, Kreu III, pika 1, paragrafi IIb. Për të provuar plotësimin e kesaj kerkese duhet të deklaroje të gjitha punet në proces për të cilat ka lidhur kontrate apo është në proces të lidhjes së saj, sipas ligjit për prokurimin publik, sipas tabelës së mëposhtme:

N r	OBJEKTI I KONTRATE S	AUTORITETI KONTRAKTO R	VLER A PA TVSH	DATA E FILLIMIT TE PUNIMEVE OSE DATA E PARASHIKUA R PER LIDHJEN E KONTRATES	DATA E PERFUNDIMI T TE PUNIMEVE OSE DATA E PARASHIKUA R PER PERFUNDIM

Kujdes! Te gjithë dokumentat duhet të jënë origjinal ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti ose të dorëzimit të dokumentave të rreme e të pasakta konsiderohen si kushte për skualifikim.

Referuar Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.42 datë 16.01.2008 Kreu III pika 1 paragrafi II b shprehet se ”Subjektet e licensuara në zbatim nuk mund të kualifikohen si fituese për punë

publike të prokuruar sipas ligjit të prokurimit publik nëse janë fitues dhe apo kanë në proces në të njëjtën kohë si kontraktor/nëkontraktor një investim sipas një kontrate të lidhur/ apo në proces për tu lidhur sipas LPP me vlerë të përbashkët apo të vecantë që tejkalon vlerën e kategorisë që mban subjekti sipas lidhjes.

Nga verifikimet në sistemin e app.gov.al buletini i njoftimeve publike Nr.13 datë 03.04.2017 operatori ekonomik Sireta 2F është shpallur fitues duke nënshkruar kontrata si BOE me Bashkinë Cërrik për objektet: 1. Rikonstruksion i shkollës kopshtit ndërtim i tereneve sportive dhe sistemit i teritorit në shkollën Mehmet Bajraktari Nja Shalës kontrata e nënshkruar më datë 22.03.2017. 2. Rikonstruksion i fushës sportive në gjimnazin Miranda Baku, Gostime kontratë e nënshkruar më datë 21.03.2017. Në deklaratën e dorëzuar në sistem operatori ekonomik ankimes nuk i ka deklaruar kontratat e nënshkruara me Bashkinë Cërrik. Përfundimi: Operatori ekonomik duhet të deklaronte në tabelë kontratat e nënshkruara me Bashkinë Cërrik. Mosdeklarimi i dy objekteve përbën shkak për skualifikim nga tenederi dhe konsiderohet informacion i rremë.

Gjithashtu nga komunikimi i kryer me përfaqësues të operatorit ekonomik Sireta 2F shpk deklarohet se të gjitha makineritë sipas shtojcës 9 "Mbi disponimin e makinerive" i kanë të angazhuara për kryerjen e punëve në Bashkinë Berat dhe Bashkinë Maliq. Për sa më sipër vendoset mospranimi i ankesës.

II.6. Në datën 26.05.2017 operatori ekonomik ankimes ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt ankesë drejtuar autoritetit kontraktor.

II.7. Nëpërmjet shkresës me nr.2087 prot datë 02.06.2017 protokolluar me tonën me nr.1013/2 datë 07.06.2017 autoriteti kontraktor ka dorëzuar informacionin e kërkuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik për procedurën e prokurimit objekt ankimi.

II.8. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton se më datë 22.05.2017 autoriteti kontraktor ka anuluar procedurën e prokurimit objekt ankimi.

II.9. Në datën 12.07.2017 Komisioni i Prokurimit Publik pas shqyrtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimes me vendimin KPP 514/2017 ka vendosur:

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik "Sireta 2F" sh.p.k për procedurën e prokurimit "Procedurë e Hapur", me Nr.REF-74760-03-29-2017 me objekt "Sistemit rrugësh blloku tek Stadiumi" me fond limit 78,906,342 lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 21.04.2017 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Pogradec.
2. Autoriteti kontraktor të anulohet vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e operatorit ekonomik "Sireta 2F" sh.pk dhe të korigjojë shkeljet duke e kualifikuar këtë operator.
3. Autoriteti kontraktor të anulohet vendimin e datës 22.05.2017 për anulimin e procedurës së prokurimit objekt ankimi.
4. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.

5. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik "Sireta 2F" sh.p.k
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

II.10. Me shkresën Nr. 2606/2 Prot, datë 11.08.2017, protokolluar me tonën nr. 514/4 prot datë 16.08.2017, autoriteti kontraktor, *Bashkia Pogradec.*, njofton se ka zbatuar vendimin K.P.P 514/2017 të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit "Procedurë e Hapur", me Nr.REF-74760-03-29-2017 me objekt "Sistemim rrugësh blloku tek Stadiumi" me fond limit 78,906,342 lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 21.04.2017 nga autoriteti kontraktor, *Bashkia Pogradec.*

II.11. Me vendimin KPP.514/5/2017 datë 16.08.2017 Komisioni i Prokurimit Publik ka vendosur heqjen e pezullimit për procedurën e prokurimit të sipërcituar pasi pas verifikimeve në sistemin e prokurimeve elektronike rezultonte se autoriteti kontraktor në datën 10.08.2017 kishte kryer rivlerësimin e procedurës së prokurimit objekt ankimi në zbatim të vendimit KPP514/2017 duke kualifikuar operatorin ekonomik "Sireta 2F" shpk.

II.12. Në datën 18.08.2017 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e rivlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezultoi si më poshtë vijon:

- Jogi	pa ofertë	I skualifikuar
- Vaya International	pa ofertë	I skualifikuar
- Boshnjaku B	57,511,677	I skualifikuar
- Sireta 2F	66,666,666	I skualifikuar
- Leon Konstruksion	66,693,652.81	I skualifikuar
- Shendelli&Shkëlqimi 07	67,078,530	I skualifikuar
- Alko Impex General Construction	67,642,538	I skualifikuar
- Ndreka	70,997,490	I skualifikuar
- Rej	73,382,898	I skualifikuar
- Building Construction	78,117,262	I kualifikuar

II.13. Në datën 18.08.2017 operatori ekonomik "Sireta 2F" shpk është njoftuar përmes sistemit të prokurimeve elektronike për skualifikimin e ofertës së tij me argumentat si më poshtë:

Me shkresën me nr. 4055 prot, të institucionit të Bashkisë Maliq, na vihet ne dispozicion shtojca nr.9, e operatorit ekonomik "SIRETA 2F" shpk, te dorezuar ne tenderin me objekt "Rikonstruksion, sistemim-asfaltim i rruges Petrushe - Vreshtas". • Nga ballafaqimi i kryer ndermjet shtojces te dorezuar ne Bashkine Pogradec dhe shtojces se dorezuar ne Bashkine Maliq se makinerite e mëposhtme jane paraqitur ne te dy procedurat. Nr Targa Nr. Lejes qarkullimit Nr. Shasise Te tjera 1 AA 711 HJ TRDB6219513 ËJMJ4CSS00C135136 KAMION IVEKO 2 AA 586 IC TRDB6219513 ËJMJ4CSS00C135136 KAMION VOLVO 4 AA 891 NR

TRDA3648416 ĚJMJ4CSS00C102852 KAMION IVEKO 5 AA 798 CP TRF0096212 ĚDB61631515461007 KAMION BENZ AUTOVINC. Për sa kohë që operatori ekonomik i ka të angazhuara makineritë në kryerjen e punimeve në objekte në Bashkitë e tjera dhe dorëzon shtojcën që i disponon këto makineri, përbën informacion, të dhëna të rremë. Për sa me sipër, referuar nenit 47 "Raportimi i skualifikimit" të ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" të ndryshuar, Bashkia Pogradec, skualifikon ofertuesin "SIRETA 2F" SHPK, PASI KA PARAQITUR të dhëna të rreme, për qëllime kualifikimi.

II.14. Në datën 24.08.2017, operatori ekonomik ankimues "Sireta 2F" sh.a, ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor me anë të së cilës kundërshton vendimin e KVO-së lidhur me riskualifikimin e ofertës së tij në mënyrë të përmbledhur me pretendimet si më poshtë:

- Së pari kemi dyshime të arsyeshme se rivlerësimi i procedurës së mësipërme të prokurimit shtë dashakeq dhe në shkëlqje të ligjit pasi ky i fundit nuk është kryer nga KSHA pas një ankese nga subjekte të legjitimuara por është kryer me vetë iniciativën e autoritetit kontraktor duke shkelur haptazi nenin 63 të LPP.
- Gjithashtu në lidhje me arsyen e skualifikimit të shoqërisë sonë ju sqarojmë se në Buletinën e datës 30 Nëntor të vitit 2016, Nr.47 datë 30 Nëntor 2016 është publikuar Njoftim Fituesi në procedurën e prokurimit me objekt Sistemim asfaltim i rrugës Petrushë-Vreshtas kjo kontratë do të zgjasë 12 muaj nga data e nënshkrimit të saj. Në këtë kontratë shoqëria jonë ka marrë pjesë si JV.
- Në lidhje me angazhimin e mjeteve të pretenduar nga autoriteti juaj dhe mbi faktin se shoqëria jonë ka bërë deklaram të remë gjejmë me vend të sqarojmë se nga data e lidhjes së kontratës dhe deri më tani nga ana e autoritetit kontraktor Bashkia Maliq janë pranuar 5 situacione punimesh për të cilat janë lëshuar dhe faturat përkatëse . Në total janë kryer punime në vlerë 77,313,436 lekë pa tvsh. Vlera totale e kontratës është 88,000,000 lekë pa tvsh. Gjithsej është përmbushur 88% e kontratës ndërkohë që shoqëria jonë Sireta 2F në këtë sipërmarrje ka marrë përsipër vetëm 42.23% të punimeve. Pra sa më sipër shoqëria jonë ka përmbushur të gjitha detyrimet e saj në përputhje me % e bashkëpunimit dhe nuk shfaq të nevojshëm angazhimin e asnjë mjeti që nga data e dorëzimit të ofertave në vijim pasi proceset e punës të marra përsipër nga shoqëria jonë referuar kontratës së bashkëpunimit si edhe situacioneve pjesore janë përmbushur në mënyrë të plotë. Pjesa tjetër e punimeve i përket anëtarëve të tjerë të JV.

II.15. Në datën 31.08.2017 me shkresën nr. 3070/1 prot operatori ekonomik ankimues "Sireta 2F" shpk, është vënë në dijeni në lidhje me refuzimin e ankesës nga autoriteti kontraktor.

II.16. Në datën 08.09.2017, pala ankimuese "Sireta 2F" shpk ka dorëzuar ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt ankese dorëzuar pranë autoritetit kontraktor.

II.17. Nëpërmjet shkresës me nr. 2958/3 prot datë 15.09.2017 protokolluar me tonën me nr.1453/2 datë 18.09.2017 autoriteti kontraktor ka dorëzuar informacionin e kërkuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik për procedurën e prokurimit objekt ankimi ku sqarohet se: Pas

rivlerësimi të ofertës dhe dokumentacionit të OE "Sireta 2F" shpk më datë 15.08.2017 është paraqitur ankesë nga operatori ekonomik Building Construction shpk protokolluar në Bashkinë Pogradec me Nr.2859 Prot me lëndë Ankesë bashkëngjitur edhe shtojca 20 Formular i ankesës pranë autoritetit kontraktor. KSHA nga shqyrtimi i ankesës së paraqitur nga ana e OE Building Construction shpk vendosi: Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik Building Construction shpk. Të skualifikojë operatorin ekonomik Sireta 2F shpk në procedurën e prokurimit me objekt "Sistemim rrugësh blloku tek Stadiumi për arsye se ka paraqitur informacion të remë.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues "Sireta 2F" shpk se "Rivlersimi i datës 18.08.2017 është kryer me iniciativë të autoritetit kontraktor pasi ky i fundit nuk është kryer nga KSHA pas një ankese nga subjekte të legjitimuara por është kryer me vetë iniciativën e autoritetit kontraktor duke shkelur haptazi nenin 63 të LPP", KPP pas shqyrtimit të informacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor me shkresën 2958/3 prot datë 15.09.2017 protokolluar me tonën me nr.1453/2 datë 18.09.2017 konstaton se rivlersimi i procedurës është kryer pas ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik "Building Construction" shpk si subjekt i legjitimuar pas marrjes dijeni lidhur me pozitën e ndryshuar të operatorit ekonomik "Sireta 2F" shpk në bazë të vendimit KPP 514/2017 datë 12.07.2017. Në këtë kuptim KPP gjykon ndodhet në kushtet kur duhet të marrë në shqyrtim arsyen e re të skualifikimit të operatorit ekonomik "Sireta 2F" shpk.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues "Sireta 2F" shpk për kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij me arsyetimin se "Me shkresën me nr. 4055 prot, të institucionit të Bashkisë Maliq, na vihet ne dispozicion shtojca nr.9, e operatorit ekonomik "SIRETA 2F" shpk, te dorezuar ne tenderin me objekt "Rikonstruksion, sistemim-asfaltim i rruges Petrushe - Vreshtas". • Nga ballafaqimi i kryer ndermjet shtojces te dorezuar ne Bashkine Pogradec dhe shtojces se dorezuar ne Bashkine Maliq se makinerite e mëposhtme jane paraqitur ne te dy procedurat. Nr Targa Nr. Lejes qarkullimit Nr. Shasise Te tjera I AA 711 HJ TRDB6219513 WJMJ4CSS00C135136 KAMION IVEKO 2 AA 586 IC TRDB6219513 ËJMJ4CSS00C135136 KAMION VOLVO 4 AA 891 NR TRDA3648416 WJMJ4CSS00C102852 KAMION IVEKO 5 AA 798 CP TRF0096212 ËDB61631515461007 KAMION BENZ AUTOVINC. Për sa kohë që operatori ekonomik i ka te angazhuara makineritë në kryerjen e punimeve ne objekte ne Bashkitë e tjera dhe dorëzon shtojcen qe i disponon keto makineri, përbën informacion, të dhëna të rremë. Per sa me siper, referuar nenit 47 "Raportimi i skualifikimit" të ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" të ndryshuar,

Bashkia Pogradec, skualifikon ofertuesin "SIRETA 2F" SHPK, PASI KA PARAQITUR te dhena te rreme, per qellime kualifikimi", Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.2.1. Në shtojcën 10 "Kriteret e Vecanta të Kualifikimit" pika 2.3.8 "Kapacitetit Teknik" të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

2.3.8. Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës:

Mjetet	Sasia	Gjendja
Kamiona	4 copë	Pronësi ose me qera
Eskavator	2 copë	Pronësi ose me qera
Fadrome	1 copë	Pronësi ose me qera
Betoniere	1 copë	Pronësi ose me qera
Autovinç	1 copë	Pronësi ose me qera

2.3.8.1 Operatori Ekonomik të paraqesë deklaratën sipas shtojcës Nr.8

2.3.8.2 Ofertuesi duhet të paraqesë për makineritë të cilat shënohen në rregjistrin kombëtar të automjeteve, lejet e qarkullimit të tyre (të cilat duhet të jenë në emër të shoqërisë), Licence dhe certifikat transport mallrash nga Pushteti vendor, Siguracionin, Kontrollin Teknik të automjetit, Taksat e qarkullimit. Për mjetet dhe pajisjet e tjera Ofertuesi duhet të paraqesë kontrate noteriale të blerjes, fatura tatimore të blerjes ose dokument zhdoganimi të mjetit.

2.3.8.3. Pranohet marrja me qira ose huapërdorje e mjeteve të mesiperme, me kusht që kontrata/t e qiramarrjes ose të huapërdorjes të jenë të lidhura para noterit për objektin që prokurohet, me afat vlefshmerie deri në përfundim të objektit si dhe të shoqerohen nga të gjitha dokumentat e mesiperme të pronesis se huadhenesit.

III.2.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike konstatohet se operatori ekonomik "Sireta 2F" shpk në përmbushje të kriterëve sa më sipër ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Shtojca 8 mbi disponimin e makinerive me përmbajtje si më poshtë:

Mjete në Pronësi				
Lloji i Mjetit	Targa	Nr. Lejes së Qarkullimit	Nr.Shasisë	Të tjera

1	AA711HJ	TRDB6219513	ËJMJ4CSS00C135136	Kamion Iveko
2	AA586IC	TRDB8206813	YV2F4B3G8VA261726	KAMION VOLVO
3	AA735PY	TRDA1104017	VF622CVA090001431	KAMION RENAULT
4	AA891NR	TRDA3648416	ËJMJ4CSS00C102852	KAMION IVEKO
5	AA798CP	TRF0096212	ËDB61631515461007	KAMION BENZ AUTOVINC
6	AAMT14	TRD0719412	0716817	ESKAVATOR JCB
7	Eskavator	Volvo Mod EC 140(14.5)	SHASI- CO12770	REGJIS.45034 DATE 10/07/2009
<i>Asete në Pronësi</i>				
		NJESIA	SASI	Te tjera
8	BETONIERE	COPE	1	Fatura Nr .137 Date 16/03/2009
<i>Makineri me Qera</i>				
9	Fadrome Caterpillar	TR 6156 K	TR 0017011	NR.7322 REP NR.4797 KOL DATE 11/06/2015- 10/06/2020
10	KONTRAT FURNIZIMI	FAVINA	INERTE + BETON	DATE 10.01.2017

III.2.3. Në nenin 46, pika 1 gërma “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese:

III.2.4. Në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”.

III.2.5. Në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 26, pika 8, parashikohet si më poshtë:
Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon:

- a) *licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose*
- b) *dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose*
- c) *dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratë”*

III.2.6. Referuar arsyes së skualifikimit për operatorin ekonomik ankimues “Sireta 2F” shpk

rezulton se ajo konsiston në verifikimin e kryer nga autoriteti kontraktor sa i takon angazhimit të disa prej mjeteve të deklaruara në shtojcën 8 “Mbi disponimin e makinerive” në një kontratë tjetër të mëparshme. Referuar parashtrimeve me shkrim në ankesë të operatorit ekonomik ankimues “Sireta 2F” shpk por edhe argumentave të autoritetit kontraktor në informacionin e vënë në dispozicion me shkresës 2958/3 prot datë 15.09.2017 protokolluar me tonën me nr.1453/2 datë 18.09.2017 rezulton se bëhët fjalë për Kontratën me objekt “Sistemim asfaltim i rrugës Petrushë-Vreshtas” lidhur ndërmjet bashkimit të operatorëve ekonomikë “Sireta 2F shpk & “Agri” shpk& “Artyka” shpk dhe autoritetit kontraktor Bashkia Maliq. Referuar aktit administrativ “Njoftim Fituesi” për kontratën e sipërcituar konstatohet se afati i punimeve për objektin në fjalë do të zgjasë 12 muaj. KPP referuar datës së Njoftim Fituesit gjykon se kjo kontratë duhet të realizohet brenda vitit 2017. Nga shqyrtimi në tërësi i dokumentacionit të administruar për shqyrtimin e kësaj anekese, KPP gjykon se kjo kontratë e lidhur mes palëve në Nëntor 2016 me objekt “Sistemim asfaltim i rrugës Petrushë-Vreshtas” është drejt përfundimit për shkak të afateve të parashikuara në të. Pra afati maksimal për përfundimin e punimeve në kushte normale do të ishte brenda afatit 2017. Akoma më tej referuar dokumentacionit bashkëngjitur ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “Sireta 2F” shpk rezulton se vetë autoriteti kontraktor Bashkia Maliq me anë të shkresës nr.4330 datë 24.08.2017 drejtuar operatorit ekonomik “Sireta 2F” shpk konfirmon se: *Subjekti Sireta 2F shpk ka realizuar punimet në objektin “Rikonstruksion Sistemim Asfaltimi i rrugës Petrushë Vreshtas në masën 88% duke u bazuar në situacionin nr.5 të punimeve të depozituara pranë Bashkisë Maliq. Subjekti Sireta 2F shpk për realizimin e punimeve të mbetura në objektin “Rikonstruksion Sistemim Asfaltimi i rrugës Petrushë Vreshtas” nuk i nevojiten makineri gërmimi dhe makineri transporti materialesh.* Në këto kushte Komisioni gjykon se kamionet e angazhuar në kontratën e lidhur me Bashkinë Maliq janë tërësisht të lira për tu vënë në dispozicion të realizimit të kontratës objekt ankimi duke krijuar njëherazi bindjen e autoritetit kontraktor mbi disponimin nga ana e operatorit ekonomik ankimues të kapaciteteve teknike (makineri) të nevojshme për realizimin me sukses të kontratës.

Gjithashtu KPP gjykon se autoriteti kontraktor në kuptim të nenit 62 të LPP ‘Detyrimet gjatë zbatimit të kontratës’ ka një rol të posaçëm, për vetë cilësimin e tij ligjor, si autoriteti me interes dhe përgjegjësi thelbësore për realizimin e suksesshëm të kontratës. KPP sjell në vëmendje se, referuar rregullave të prokurimit publik, është pikërisht autoriteti kontraktor ai që duhet të monitorojë zbatimin e kontratës, për t’u siguruar nëse cilësia e punës do të jetë e njëjtë me cilësinë e premtuar në ofertë dhe të përcaktuar në kontratë. Në rast të shkeljes së kushteve të kërkuara, autoriteti kontraktor zbaton penalitetet e parashikuara në kontratë, apo detyrimet, në mbështetje të nenin 62 të LPP-së, si më sipër cituar. KPP gjykon se në rastin konkret argumentat e dhëna nga autoriteti kontraktor se mjetet janë të angazhuara në kontratën me objekt “Sistemim asfaltim i rrugës Petrushë-Vreshta” duke penalizuar operatorin ekonomik ankimues në procedurën e prokurimit objekt ankimi nuk rezultojnë të jenë aktuale për shkak se punimet për këtë kontratë janë realizuar në masën 80% dhe për pjesën tjetër të punimeve të mbetura ashtu sikundër konfirmohet në shkresën e sipërcituar nuk nevojiten makineri gërmimi dhe makineri transporti materialesh. Për të gjitha rrethanat e lartpërmendura KPP gjykon në momentin e lidhjes së kontratës së re me objekt “Sistemim rrugësh blloku tek Stadiumi”, mjetet të cilat autoriteti pretendon se nuk janë të disponueshme nga ankimuesi do të jenë

tërësisht të lira dhe të angazhuara për këtë kontratë për shkak të kohës në të cilën do të lidhet dhe do realizohet kontrata objekt ankimi. Në këtë kuptim KPP gjykon se dokumentacioni i dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues në përmbushje të kriterit për disponimin e makinerive është tërësisht i vlefshëm.

Sa më sipër pretendimi i ankimuesit qëndron.

Për sa më sipër në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, nenit 28 të VKM-së nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “Sireta 2F” shpk për procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me Nr.REF-74760-03-29-2017 me objekt “*Sistemim rrugësh blloku tek Stadiumi*” me fond limit 78,906,342 lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 21.04.2017 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Pogradec.
2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e operatorit ekonomik “Sireta 2F” shpk dhe të korigjojë shkeljet duke e kualifikuar këtë operator.
3. Autoriteti kontraktor, brënda 10 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “Sireta 2F” shpk
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr.1453 Protokoli; Datë 08.09.2017

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Zv/Kryetar
Leonard Gremshi

Anëtar
Hektor Balluku

Anëtar
Odise Moçka

Kryetar
Evis Shurdha